




Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit

Opština Gnjilane

Municipal Gjilan

Gilan Belediyesi

DEPARTAMENTI I PROKURIMIT
DEPARTAMENT NABAVKE
DEPARTMENT OF PROCUREMENT
IHALENIN BÖLÜMÜ

KONTRATË SHËRBIMI

(hartimi I projektit ideor)

Gjilan, Korrik 2019.

Palët e poshtëshenuara mbi bazën e procedurave të prokurimit të udhëhequra nga autoriteti kontraktues Komuna e Gjilanit sipas numrit të prokurimit: **651-19-3018-2-2-3**, janë dakorduar të lidhin këtë:

K O N T R A T Ë S H È R B I M I

(hartimi I projektit ideor)

Komuna e Gjilanit, Rruga “Bulevardi I Pavarësisë”, p.n, të cilin e përfaqeson: Izet Kurteshi, Zyrtarë Përgjegjës i Prokurimit (në tekstin e mëtejshëm: POROSIËSI i projektit), dhe

“**INFRA PLUS**” **SH.P.K** nga Prishtina, përfaqesuar nga Musa Islamaj drejtor (në testin e më tejshëm: HARTUES i projektit ideor).

Neni 1.

Lënda e kësaj kontrate është:

“ Hartimi i projektit ideor per parkun e qytetit Parku i Paqes Livadhet e Arapit “

me nr. të prokurimit **651-19-3018-2-2-3** dhe

me nr. të brendshëm **GL 651 19 047 223**

Kjo nënkupton edhe hartimin e projekteve kryesor për të gjitha fazat e nevojshme: *Në Planin Rregullues Urban, lokacioni i destinuar për parkun e qytetit – “Parkun e Paqes”, është i rrethuar me rrugë banimi në tri anë dhe kufizohet me lumin Mirusha në anën më të gjatë. Përmbajtjet e rekomanduara nga PRrU për këtë hapësirë janë këto •Gjelbërim •Lojëra për fëmijë •Hapësira për piknik •Sport dhe rekreacion •Hapësirat e mbyllura (salla për ushtrime, salla për sporte luftarake, pishinia, biliri) •Hapësirat e jashtme (fusha e futbollit me shtigje të atletikës, terrene sportive, pishina) •Përmbajtje të përkohshme hotelierike.*

Neni 2.

Bazë për hartimin e projektit kryesor të specifikuar në nenin 1 është projekti ideor me të gjitha fazat e nevojshme (pjesa tekstuale dhe pjesa grafike),dokumentacioni tjetër percjellës si dhe detyra projektuese që ishte pjesë e konkursit të projektimit.

Neni 3.

Autoritet kontraktues me vendim të veçantë do të caktoj një grup punues me qëllim të monitorimit të aktiviteteve të hartuesit – hartuesve të projekteve kryesore, duke pasur në konsiderat projektin ideor të përgjeshur dhe dokumentacionin tjetër percjellës por edhe do të aprovoj zgjidhjet-projektet e ofruara.

Neni 4.

Detyrat,përgjegjësit dhe obligimet e grupit punues do të specifikohen me vendim te veçantë-dokument që do të hartohet nga autoriteti kontraktues

Neni 5.

Hartuesi i projektit obligohet që në afat prej **pesë** ditësh pune pas nënshkrimit të kontratës të hartoj dokumentin - Planin dinamik me aktivitetet e caktuara të specifikuara në aspektin kohor duke respektuar strikt afatin kohor prej **30 ditësh** pune ky dokument do ti dorëzohet kryesuesit të grupit punues.

Neni 6.

6.1. Shfrytëzuesi i shërbimeve –Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjilanit obligohet që për shërbimet e kontraktuara ti paguaj kontraktorit të zgjedhur nga juria profesionale për **“Hartimin e projektit ideor per parkun e qytetit Parku i Paqes Livadhet e Arapit ”** shumën: **9,950.00 €**; (Nëntë mijë, nëntëqind e pesëdhjetë Euro. Zero zero cent), kjo shumë është e pa ndryshueshme.

6.2. Afati i fundit për hartimin dhe dorëzimin e projektit ideor është **30 ditë** pune duke filluar pesë ditë pune pas datës së nënshkrimit të kontratës .

6.3.Shfrytëzuesi i shërbimit pagesën do ta bëjë pas miratimit –aprovimit të projektit-projekteve me shkrim (Në formë të shkruar) nga anëtarët e grupit punues dhe aprovimit të faturës së hartuar nga kompania-hartuese. Pagesa ekzekutohet përmes xhirollogarisë.

6.4. Pagesa projektuesit do ti bëhet pas hartimit të projektit ideor i cili projekt do të dorëzohet në zyrën e projekteve ku edhe do të bëhet pranimi i tij.

Neni 7.

Projekti ideor duhet të dorëzohet në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike në CD, te zyrtari i caktuar në zyrën e projekteve dhe nga i njëjti do të pranohet dokumentin përkatës për pranim-dorëzimin e projekteve.

Neni 8.

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Gjilanit do ta bëjë pagesën Kompanisë sipas Çmimit të cekur në nenin 6 për **“ Hartimin e projektit ideor per parkun e qytetit Parku i Paqes - Livadhet e Arapit ”**.

Neni 9.

Kompania-hartuesi i projektit është përgjegjës (në aspektin ligjor)dhe garanton se projekti kryesor është punuar në mënyrën profesionale duke respektuar rregulloren aktuale ligjore që ka të bëjë me hartimin e dokumentacionit teknik.

Neni 10.

Për të gjitha çështjet që nuk janë paraparë në kontratë, vlejné dispozitat përkatëse të ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve (dispozitat për marrëdhëniet kontraktuese).

Neni 11.

11.1. Çfarëdo vërejtje lidhur me këtë kontratë qe mund të vijë nga auditimi i jashtëm, i brendshëm dhe autoriteti tjetër i autorizuar me ligj, palët obligohen ti mënjanojnë vërejtjet eventuale menjëherë në kontratë.

11.2. Palet kontraktuese heqin dorë nga ç'do lloj kontestimi por nëse lind ndonjë kontest do ta zgjedhin me marrëveshje ne afatin për të cilin merren vesh palët, nëse palët nuk mund te arrijnë marrëveshje atëherë kontestin do ta zgjidhë gjykata kompetente ne Kosovë.

Neni 12.




Kontrata konsiderohet e lidhur nga palët kontraktuese në momentin e nënshkrimit të kontratës nga palët kontraktuese.

Neni 13.

Kjo kontrata është përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin kontraktues

Për Kontraktuesin

Emri:	Izet Kurteshi	Emri:	Musa Islamaj
Pozita:	Zyrtarë Përgjegjës i Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	11.07.2019	Data:	11.07.2019
Vula:		Vula:	

Projekti: HARTIMI I PROJEKTEVE IDEORE PËR PËRMBAJTJET E CAKTUARA QË GJENDEN NË KUADER TË HAPSIRËS TË DEFINUAR PËR PARK TË QYTETIT TË EMËRTUAR SI "PARKU I PAQES" NË VENDIN LIVADHET E ARAPIT/ GJILAN

Maj 2019

POZICIONI

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Pershkrimi i punëve

Njësia

Sasia

Çmimi - €

Totali - €

1

Hartimi I iprojektit ideor për përmbajtje të caktuar që gjendet në kuadër të hapsirës të definuar për park të fshatit të emruar si "PARKU I PAQES" në vendin Livadhet e Arapit /Gjilan

1.0

1.0

9950.00

9,950.00

Gjithsej

9,950.00

